



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/126;
Datë: 24.02.2017 .

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Fort.	Nr.faq	Data
2-moh/423	1	28.02.2017

Në bazë të neneve 11, 12.1 dhe 12.2 paragrafi d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008) dhe nenit 22.1 paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 7 paragrafi 6 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 24.02.2017 nxjerrë:

VENDIM

për miratimin e

Raportit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2016

- I. Me këtë vendim miratohet Raporti i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2016/në tekstin e mëtejme raporti/.
- II. Raporti është dokument publik dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ

kryesues



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270
<http://rks-gov.net/junik>



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK



Referencë:	Numër: 2-358/17
Për/Za/To:	Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut
Nga/Od/From:	z. Faik Tofaj – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut
Datë/Datum/Date:	06.02.2017
Tema/Subjekat/Subject:	RAPORT PUNE

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nr.i faq	Data
2-470/1424	10	28.02.2017

Vendi: Komuna e Junikut

Hartuesi: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut

Lloji i punës: Raport pune

“RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2016”

Junik, shkurt 2017

Kuvendi i Komunës së Junikut në përputhje me obligimet që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës së Junikut, Rregullorja e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe ligjet e tjera në Republikën e Kosovës, për vitin 2016 harton këtë:

RAPORT PUNE

Kuvendi i Komunës së Junikut është organi më i lartë i themeluar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (neni 35).

Kjo është legjislatura e katërt e këtij organi e dalë nga zgjedhjet lokale 2013.

Kuvendi i Komunës së Junikut numëron gjithsejtë 15 anëtarë prej të cilëve 9 janë meshkuj dhe 6 femra. Në kuvend janë të përfaqësuara katër subjekte politike: AAK me 6 këshilltarë; LDK me 5 këshilltarë; LVV me 2 këshilltarë dhe PDK me 2 këshilltarë.

Përveç Kuvendit si organ ligjvënës në kuadër të tij janë të themeluara edhe trupa ndihmës siç janë komitetet dhe komisionet. Deri më tash janë të themeluara 3 komitete (dy të përhershme Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete) dhe (një komitet tjetër – Komiteti për Shërbime Publike), Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, 4 komisione (Komisioni për Emërtimin e Zonave të Qarkullimit Publik, Komisioni për Përzgjedhjen e Stëmës së Komunës së Junikut, Komisioni Vlerësues për Dhënien e Pronës së Paluajtshme Komunale në Shfrytëzim dhe Komisioni i Ankesave) si dhe Grupi i Femrave të Komunës së Junikut.

Mirëpo për të gjitha çështjet tjera siç janë dërgimi i materialit, arkivimi si dhe evidentimi protokollar i të gjithë materialit të kuvendit është punuar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ MAPL Nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Statutin e Komunës së Junikut dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut duke respektuar aq sa ka qenë e mundur Planin e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2016.

Në kuadër të projektit **DEMOS** partnere e të cilit është edhe Komuna e Junikut gjatë vitit 2016 janë organizuar disa punëtori të cilat u mundësuan nga organizata HELVETAS Swiss Intercooperation e cila financohet nga Qeveria e Zvicrës:

Më 14 dhe 15 mars në Prishtinë është mbajtur punëtorja 2 ditore me temën: “**Auditimi, prokurimi dhe roli i kuvendit të komunës në këto fusha**”. Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Junikut derisa në këtë punëtori janë trajtuar shumë tema nga fusha e auditimit dhe prokurimit publik siç janë: *korniza ligjore për auditim; institucionet përgjegjëse për auditim; fazat e procesit të auditimit; prezantimi i raportit të auditorit të përgjithshëm; prezantimi i planit të komunës për adresimin e të gjeturave të auditorit të përgjithshëm; roli dhe rëndësia e kuvendit të komunës në procesin e auditimit; korniza ligjore për prokurim publik; institucionet përgjegjëse për prokurim publik; fazat e procesit të prokurimit publik; plani vjetor i prokurimit publik; etj. .*

Më 7 dhe 8 nëntor në Gjilan për anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe të Novo Brdo – s po ashtu në kuadër të projektit DEMOS është organizuar punëtorja dy ditore me temën: **“Leximi i raporteve financiare”**. Edhe në këtë punëtori janë trajtuar tema të rëndësishme nga fusha e raportimeve financiare si: *obligimet ligjore për raportim të ekzekutivit në kuvendin e komunës; kërkesat e qytetarëve dhe inkorporimi i tyre në buxhet; procedurat e hartimit të planit të rrjedhës së parasë; procedura e hartimit të planit për investime kapitale; përmbajtja e dokumentit të buxhetit vjetor dhe leximi i tij; përmbajtja e raporteve tre mujore financiare dhe leximi i tyre; monitorimi i zbatimit të akteve komunale (rregulloreve, strategjive, planeve, etj.) dhe kostoja për zbatimin e tyre; etj.* .

Më 29 dhe 30 nëntor 2016 në Shkup në kuadër të projektit DEMOS është mbajtur punëtori lidhur me **planifikimin vjetor të punës për vitin 2017**. Pjesëmarrëse në këtë punëtori ka qenë komuna e Junikut si dhe të gjitha komunat e Republikës së Kosovës që janë pjesë e këtij projekti. Qëllimi i mbajtjes së këtij takimi ka qenë planifikimi i punëve dhe aktiviteteve për vitin 2017 në të gjitha komunat pjesëmarrëse të projektit DEMOS. Takimi kryesisht është përqendruar në: *menaxhimin e mbeturinave në nivel lokal si dhe raportet mes ekzekutivit dhe legjislativit në nivel lokal*.

Më 1 dhjetor 2016 në Deçan është mbajtur trajnimi një ditor për anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa në temën: **“Bashkëpunimi ndër komunal”** . Në këtë punëtori janë trajtuar shumë tema nga fusha e bashkëpunimit ndër komunal si: *korniza ligjore që e rregullon fushën e bashkëpunimit ndër komunal; baza, struktura dhe fushat e bashkëpunimit ndër komunal; përfitimet dhe inicimi i bashkëpunimit ndër komunal; roli i Kuvendit Komunal në bashkëpunimin ndër komunal; marrëveshjet e modeleve ndër komunale; etj.* .

Gjatë vitit 2016 Kuvendi i Komunës së Junikut ka mbajtur gjithsejtë 12 mbledhje të rregullta dhe 1 mbledhje solemne (17 Shkurti Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës) derisa mbledhje të jashtëzakonshme dhe mbledhje urgjente nuk janë mbajtur për arsye se për të tilla mbledhje nuk është paraqitur nevoja.

Pothuajse në të gjitha mbledhjet ka mbizotëruar fryma e arsyes dhe janë trajtuar çështje të rëndësishme për komunën e Junikut.

Komitetet e përhershme (Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete) gjatë vitit 2016 kanë mbajtur gjithsejtë 12 mbledhje të rregullta sipas planeve të miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut, Komiteti për Shërbime Publike ka mbajtur gjithsejtë 6 mbledhje të rregullta, kurse Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur gjithsejtë 4 mbledhje të rregullta.

Puna e komisioneve të ngritura nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut do të pasqyrohet në raportin e punës së secilit komision veç e veç.

RREGULLORET:

Kuvendi i Komunës së Junikut për vitin 2016 ka miratuar gjithsejtë 4 rregullore.

1. Rregulloret e miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut në vitin 2016 janë:
 - 1.1. Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2017 (vendimi i KKJ numër 02/101 i datës 26.08.2016);
 - 1.2. Rregullorja për simbolet, titujt e nderit, dekoratat, medaljet, mirënjohjet dhe falënderimet (vendimi i KKJ 02/121 i datës 25.11.2016); dhe
 - 1.3. Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale (vendimi i KKJ numër 02/111 i datës 23.12.2016);

DOKUMENTET STRATEGJIKE:

Kuvendi i Komunës së Junikut për vitin 2016 ka miratuar gjithsejtë 4 dokumente strategjike. Dokumentet strategjike komunale të miratuara në vitin 2016 janë:

1. Plani komunal për eficiencë të energjisë 2016-2022 (vendimi i KKJ numër 02/88 i datës 29.04.2016);
2. Plani i veprimtimit për transparencë komunale në Komunën e Junikut (vendimi i KKJ numër 02/90 i datës 27.05.2016);
3. Plani për mobilitet të qëndrueshëm urban në komunën e Junikut (vendimi i KKJ numër 02/91 i datës 27.05.2016);
4. Plani për mirëmbajtje dhe plani investiv për hapësira të hapura publike (vendimi i KKJ numër 02/94 i datës 30.06.2016);

BUXHETI:

I. Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Junikut për vitin 2016 ka qenë 1.170.878,00 €, dhe është i shpërndarë në linjat buxhetore si në vijim:

1. Paga dhe mëditje: 932.035,00 €,
2. Mallra dhe shërbime: 125.298,00 €,
3. Shpenzime komunale: 30.000,00 €,
4. Subvencione dhe transfere: 5.755,00 €,
5. Investime kapitale: 77.791,00 €.

(vendimi i KKJ numër 02/65 i datës 30.10.2015)

Përveç kësaj gjatë vitit 2016 Kuvendi i Komunës së Junikut ka nxjerrë gjithsejtë 45 akte prej të cilave të gjitha janë vendime. Nuk ka nxjerrë asnjë rekomandim dhe asnjë njoftim për arsye se për të njëjtat nuk është bërë asnjë kërkesë.

Në vijim në mënyrë tabelore po paraqesim aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Junikut në vitin 2016.

AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS SË JUNIKUT PËR VITIN 2016

Nr.	Emërtimi	Numri i vendimit	Data e vendimit	Data e miratimit	Vërejtje
01	Vendimi për datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të KK Junik për vitin 2016	02/72	29.01.2016	29.01.2016	
02	Vendim për miratimin e planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2016	02/73	29.01.2016	29.01.2016	
03	Vendimi për fillimin e hartimit të projekt Rregullores për simbolet, titujt e nderit, dekoratat, medaljet, mirënjohjet dhe falënderimet	02/74	29.01.2016	29.01.2016	
04	Vendim për fillimin e hartimit të projekt Planit për mobilitet të qëndrueshëm urban në komunën e Junikut	02/75	29.01.2016	29.01.2016	
05	Vendim për fillimin e hartimit të projekt Planit për mirëmbajtje të hapësirave të hapura publike në komunën e Junikut	02/76	29.01.2016	29.01.2016	
06	Vendimi për hapjen e diskutimit publik për projekt Planin komunal për efikasitet të energjisë në komunën e Junikut	02/77	26.02.2016	26.02.2016	
07	Vendimi për hapjen e diskutimit publik për projekt Planin për mobilitet të qëndrueshëm urban në komunën e Junikut	02/78	26.02.2016	26.02.2016	
08	Vendimi për hapjen e diskutimit publik për	02/79	26.02.2016	26.02.2016	

	projekt Planin për mirëmbajtje të hapësirave të hapura publike në komunën e Junikut				
09	Vendim për miratimin e raportit të punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2015	02/80	26.02.2016	26.02.2016	
10	Vendim për miratimin e Raportit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2015	02/81	26.02.2016	26.02.2016	
11	Vendim për hapjen e diskutimit publik për projekt Planin e veprimit për transparencë komunale në Komunën e Junikut	02/82	30.03.2016	30.03.2016	
12	Vendim për fillimin e hartimit të projekt Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoha komunale	02/83	30.03.2016	30.03.2016	
13	Vendim për fillimin e hartimit të projekt Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2016	02/84	30.03.2016	30.03.2016	
14	Vendim për shkarkimin e anëtarit të Komitetit për Shërbime Publike	02/85	29.04.2016	29.04.2016	
15	Vendim për shkarkimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete	02/86	29.04.2016	29.04.2016	
16	Vendim për bartje të buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në këtë vit	02/87	29.04.2016	29.04.2016	
17	Vendim për miratimin e Planit për efikasitet të energjisë 2016-2022	02/88	29.04.2016	29.04.2016	
18	Vendim për korrigjimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut numër 02/87	02/89	11.05.2016	11.05.2016	
19	Vendim për miratimin e Planit të veprimit për transparencë komunale në	02/90	27.05.2016	27.05.2016	

	Komunën e Junikut				
20	Vendim për miratimin e Planit për mobilitet të qëndrueshëm urban në komunën e Junikut	02/91	27.05.2016	27.05.2016	
21	Vendim për ndarjen e çmimit të parë "KUVENDI I JUNIKUT"	02/92	27.05.2016	27.05.2016	
22	Vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2017-2019	02/93	30.06.2016	30.06.2016	
23	Vendim për miratimin e Planit për mirëmbajtje dhe planit investiv për hapësira të hapura publike	02/94	30.06.2016	30.06.2016	
24	Vendim për hapjen e diskutimit publik për projekt Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2017	02/95	30.06.2016	30.06.2016	
25	Vendim për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2017	02/96	30.06.2016	30.06.2016	
26	Vendim për themelimin e Komisionit Vlerësues për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim	02/97	29.07.2016	29.07.2016	
27	Vendim për refuzimin e kërkesës së LVV për plotësimin e përbërjes së Komitetit për Shërbime Publike	02/98	29.07.2016	29.07.2016	
28	Vendim për hapjen e diskutimit publik për projekt Rregulloren për simbolet, titujt e nderit, dekoratat, medaljet, mirënjohjet dhe falënderimet në Komunën e Junikut	02/99	29.07.2016	29.07.2016	
29	Vendim për përbërjen e Komisionit Vlerësues për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim	02/100	26.08.2016	26.08.2016	
30	Vendim për miratimin e	02/101	26.08.2016	26.08.2016	

	Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2017				
31	Vendim për themelimin e Komisionit të Ankesave	02/102	26.08.2016	26.08.2016	
32	Vendim për korrigjimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut numër 02/95	02/103	30.08.2016	30.08.2016	
33	Vendim për korrigjimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Junikut numër 02/96	02/104	30.08.2016	30.08.2016	
34	Vendim për miratimin e buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2017	02/105	23.09.2016	23.09.2016	
35	Vendim për miratimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2017	02/106	23.09.2016	23.09.2016	
36	Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale	02/107	23.09.2016	23.09.2016	
37	Vendim për hapjen e diskutimit publik për projekt Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale	02/108	28.10.2016	28.10.2016	
38	Vendim për plotësimin e përbërjes së Komisionit Vlerësues për Dhënien e Pronës së Paluajtshme Komunale në Shfrytëzim	02/109	28.10.2016	28.10.2016	
39	Vendim për zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit Vlerësues për Dhënien e Pronës së Paluajtshme Komunale në Shfrytëzim	02/110	22.11.2016	22.11.2016	
40	Vendimi për miratimin e rregullores për simbolet, titujt e nderit, dekoratat, medaljet, mirënjohjet dhe falënderimet	02/121	25.11.2016	25.11.2016	
41	Vendim për miratimin e Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale	02/111	23.12.2016	23.12.2016	

42	Vendim për miratimin e Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2017	02/112	23.12.2016	23.12.2016	
43	Vendim për miratimin e Planit të punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2017	02/113	23.12.2016	23.12.2016	
44	Vendim për pagesën e punës së Komisionit Vlerësues për Dhënien e Pronës së Paluajtshme Komunale në Shfrytëzim	02/114	23.12.2016	23.12.2016	
45	Vendim për përbërjen e Komisionit të Ankesave	02/115	23.12.2016	23.12.2016	

Përfundim:

Në këtë raport pune janë pasqyruar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut, por kurrësi nuk mund ta konsiderojmë si të plotë, pasi që nuk kanë mundur të pasqyrohen edhe aktivitetet e trupave ndihmës të Kuvendit të Komunës së Junikut për shkak të mungesës së raporteve të punës së tyre (përveç raportit të punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2016 i cili po i prezantohet sot kuvendit për shqyrtim dhe miratim) për vitin 2016 të cilat pas hartimit duhet t'i prezantohen Kuvendit të Komunës së Junikut për shqyrtim dhe miratim.

Përfundimisht Kuvendi i Komunës së Junikut në vitin 2016 ka funksionuar në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Statutin e Komunës së Junikut dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut duke u ballafaquar me probleme si të natyrës teknike (logjistike) ashtu edhe të natyrës ligjore dhe bashkëpunimit me ekzekutivin sa u përket respektimit të procedurave ligjore lidhur me shqyrtimin dhe miratimin e dokumenteve strategjike komunale.

Me këtë rast në emër të Kuvendit të Komunës së Junikut Ju falënderoj të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Junikut për kontributin e dhënë deri më tash.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik TOFAJ

kryesues

